



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Caku për reduktimin e humbjeve

Përgjigje ndaj komenteve

**Shqyrtimi periodik i vlerave hyrëse për OST/OT-në dhe
OSSH-në**

(2018-2022)

DEKLARATË

Ky Raport i Përgjigjeve është përgatitur nga ana e ZRRE-së me qëllim të informimit të palëve të interesit të sektorit të energjisë. Raporti nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

4 prill 2018



Përmbajtja

1	Hyrje	1
2	Humbjet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.....	2
2.1	Përmbledhja e komenteve të KEDS-it.....	2
2.2	Dështimi i KEK-ut për të arritur caqet e humbjeve.....	3
2.3	Arritjet në PRR1 dhe implikimet për PRR2.....	3
2.4	Konkluzionet dhe propozimet e ZRRE-së për humbjet e OSSH-së.....	3
3	Humbjet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit	5
3.1	Përmbledhja e komenteve të KOSTT-it.....	5
3.2	Pozicioni i ZRRE-së për komentet e KOSTT-it.....	6
3.3	Konkluzionet dhe propozimet e ZRRE-së për humbjet e OST-së	6



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është duke kryer Shqyrtimin Periodik për Periudhën e Dytë Rregullative (PRR2) për të përcaktuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), Operatorin e Tregut (OT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për periudhën 1 prill 2018 deri 31 mars 2023. KOSTT SH.A. kryen aktivitetet e OST/OT, ndërsa KEDS SH.A. të OSSH-së. Të hyrat e lejuara aktuale u përcaktuan në Shqyrtimin e parë Periodik në vitin 2013 për Periudhën e Parë Rregullative (PRR1) 2013-2017.

Si pjesë e këtij shqyrtimi, ZRRE-ja do të përcaktojë një numër të ndryshoreve kryesore të inputeve për llogaritjen e MAR-it paraprakisht në mënyrë që të sigurojë kohë të mjaftueshme për konsultimin publik të tyre. Kjo është praktika e njëjtë që është zbatuar për PRR1. Vlerat e inputeve në fjalë janë:

- **Niveli fillestar dhe norma e pritur e reduktimeve në humbjet e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, që është subjekt i këtij raporti konsultativ.**
- Norma e pritur e përmirësimeve të efijencës në kostot operative të OST/OT dhe OSSH.
- Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC) të OST/OT dhe OSSH.
- Jetëgjatësia e përshtatshme e aseteve që do të përdoret për qëllime të llogaritjes së zhvlerësimit rregullativ të investimeve të reja.
- Faktori i ndarjes së humbjeve.
- Faktori ndarës i kursimeve i cili aplikohet për kursimet të cilat tejkalojnë faktorin e efikasitetit, dhe
- Ndonjë parametër tjetër hyrës që rregullatori mund ta konsiderojë të nevojshëm.

ZRRE-ja ka publikuar një Raport Konsultativ me propozimet e veta për humbjet në sistem me 4 korrik 2017. Janë pranuar dy grupe të komenteve – nga KOSTT-i dhe nga KEDS-i. Të dy grupet e komenteve janë publikuar në ueb faqen e ZRRE-së së bashku me këtë raport.

Ky Raport i Përgjigjeve përmbledh komentet e pranuar nga KEDS-i dhe KOSTT-i rreth humbjeve të propozuara në rrjet të cilat do të mbulohen në Periudhën Rregullative PRR2 dhe përgjigjet e ZRRE-së ndaj tyre.

Pas publikimit të këtij raporti, Bordi i ZRRE-së do të shqyrtojë dhe do të bëjë përcaktimin përfundimtar të nivelit të lejuar të humbjeve dhe caktim për reduktimin e tyre që do të përfshihen në MAR të OSSH dhe OST/OT-së në Periudhën e Dytë Rregullative (PRR2).

Dokumentet relevante

Ligji për Energjinë Elektrike	http://ero-ks.org/2016/Ligjet/LIGJI_PER_ENERGJINE_ELEKTRIKE.pdf
-------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



Ligji për Rregullatorin e Energjisë	http://ero-ks.org/2016/Ligjet/LIGJI_PER_RREGULLATORIN_E_ENERGJISE.pdf
Rregulla për të Hyrat e OST/OT	http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20OST_OT.pdf
Rregulla për të Hyrat e OSSH	http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20OSSH.pdf
Raporti Konsultativ i ZRRE-së për Cakun e Reduktimit të Humbjeve në PRR2	http://ero-ks.org/2017/Tarifat/Raport_Konsultativ_per_reduktimin_e_humbjeve_04072017.pdf
Komentet e KEDS-it në Raportin Konsultativ të ZRRE-së për Cakun e Reduktimit të Humbjeve në PRR2	http://ero-ks.org/2017/Tarifat/Komentet%20ndaj%20Raportit%20Konsultative%20t%C3%AB%20ZRRE%20per%20cakun%20e%20reduktimit%20t%C3%AB%20humbjeve_KEDS.pdf
Komentet e KOSTT-it në Raportin Konsultativ të ZRRE-së për Cakun e Reduktimit të Humbjeve në PRR2	http://ero-ks.org/2017/Tarifat/Komente%20ndaj%20Raporteve%20Konsultative%20te%20Vlerave%20Hyrese%20per%20WACC%20humbje%20dhe%20jetegjatesin%20e%20aseteve_KOSTT.pdf

2 Humbjet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

2.1 Përmbledhja e komenteve të KEDS-it

Në komentet e veta, KEDS-i ka ngritur tri çështje kryesore:

- Kur KEDS-i morri nën kontroll sistemin e shpërndarjes pas privatizimit, humbjet e realizuara veç tejkalonin nivelin e caktuar të humbjeve të ZRRE-së me 1.9 pikë përqindjeje për shkak të dështimit të ndërmarrjes shtetërore, KEK, për të arritur reduktimin e pritshëm të humbjeve. Kjo ka vënë KEDS-in në disavantazh financiar në krahasim me pritjet.
- Që kur ka marrë kontrollin, KEDS-i ka investuar shumë në sistemin e shpërndarjes për të reduktuar humbjet teknike, të cilat kanë rënë për 3.26 pikë përqindjeje.
- KEDS gjithashtu ka qenë në gjendje të reduktoj humbjet komerciale (vjedhjet) për 4.5 pikë përqindjeje. Megjithatë, mundësia për të bërë reduktime të mëtejshme është kufizuar nga sundimi i dobët i ligjit në Kosovë, duke e bërë zbatimin e vështirë, si dhe niveli i lartë i papunësisë dhe varfërisë që e bëjnë vjedhjen atraktive.



Për PRR2, KEDS propozon që ti njihet kjo situatë duke rivendosur bazën e humbjeve të lejuara të shpërndarjes në fillim të PRR2 të barabartë me vlerën e parashikuar për vitin 2017 prej 22.9%¹ dhe pastaj duke e reduktuar këtë me nga një pikë përqindje në vit nga viti 2018 e tutje. Në fund të periudhës PRR2 në vitin 2022, kjo do të nënkuptonte lejim të humbjeve prej 17.9% krahasuar me propozimin e ZRRE-së prej 13.2%.

Në këtë seksion, ZRRE-ja ka shqyrtuar propozimet e KEDS-it. Konkluzionet e ZRRE-së janë dhënë në fund të seksionit.

2.2 Dështimi i KEK-ut për të arritur caqet e humbjeve

Deklarimi i KEDS-it se ka qenë financiarisht në disavantazh për shkak të dështimit të KEK-ut për të arritur caqet e reduktimeve të humbjeve nënkupton një kërkesë për një formë kompensimi përmes caqeve më të ulëta të reduktimit të humbjeve në PRR2. Për të marrë parasysh këtë, është me rëndësi të kuptohet historia e vendosjes së hershme të caqeve për reduktimin e humbjeve. ZRRE-ja krijoi një rrugë shumëvjeçare për humbjet e lejuara në shpërndarje si përgjigje ndaj kërkesave të këshilltarëve të transaksionit të Qeverisë të cilët e konsideruan këtë të nevojshme për të ofruar një siguri për ofertuesit për bizneset e KEK-ut të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë.

Prandaj, caqet e humbjeve kanë qenë të njohura para transaksionit dhe informatat të cilat kanë qenë të bazuara ishin në dispozicion për të gjithë ofertuesit potencial si pjesë e procesit të tyre të vlerësimit. Vlerësimi i rreziqeve që këto caqe nuk do të arrihen nga KEK-u ose pas privatizimit ishte çështje e ofertuesve dhe kostoja e rreziqeve të mbetura do të faktorizohej në çmimet e tyre të ofertës. Duke pasur parasysh këtë, ZRRE-ja konsideron se nuk ka asnjë arsytim për ndonjë kompensim të nënkuptuar ndaj KEDS-it.

2.3 Arritjet në PRR1 dhe implikimet për PRR2

Përderisa KEDS-i ka dështuar të arrijë cakun e reduktimit të humbjeve gjatë PRR1, ZRRE-ja pranon se ai ka arritur të reduktojë ndjeshëm humbjet në shpërndarje. Midis viteve 2012 dhe 2017, humbjet kanë rënë për 8.3 pikë përqindjeje që përfaqëson një reduktim mesatar vjetor prej 1.7 pikë përqindjeje.

Nuk është e qartë nga komentet e KEDS-it se pse pret që kjo normë e reduktimit të humbjeve të ngadalësohet në PRR2, ashtu siç nënkuptohet nga propozimi i vetë për humbjet e lejuara. Nëse asgjë tjetër, do të ishte e pritshme që përfitimet e investimeve të kaluara dhe atyre që janë duke u bërë në sistemin e shpërndarjes si dhe përvoja më e madhe në bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore të Kosovës do të lejonte një reduktim më të shpejtë të humbjeve se sa që është arritur më parë. Prandaj, një normë e ngjashme e reduktimit të humbjeve si në PRR1 duhet të shihet si niveli minimal i pritshëm i performancës.

2.4 Konkluzionet dhe propozimet e ZRRE-së për humbjet e OSSH-së

Si konkluzion, ZRRE-ja nuk e konsideron se janë të arsyeshme as shqyrtimi i rritjes së vlerës bazë të humbjeve për PRR2, nga caku i vlerës në përfundim të PRR1, e as norma më e ulët e reduktimit të

¹ Vlera prej 22.9% ka qenë parashikim i KEDS-it, edhe pse realizimi i vitit 2017 është 24%.



humbjeve të propozuar nga KEDS, prej 1.0 pikë përqindjeje vjetore. Megjithatë, ZRRE-ja vë në dukje se nëse KEDS do të ishte në gjendje që thjeshtë të mbajë normën e trendit të reduktimit të humbjeve prej 1.7-1.9 pikë përqindjeje vjetore (përgjashtu realizimin e vitit 2017), mund të pritej të reduktonte humbjet nga niveli i realizuar prej 24 % në vitin 2017 në 13.5% në vitin 2022. Kjo është pothuajse identike me vlerën e caktuar të propozuar nga ZRRE-ja prej 13.2% (bazuar në mesataren rajonale të vitit 2012). Kjo do të thotë që KEDS-i do të arrijë humbje të krahasueshme në fund të kësaj periudhe me ato të siguruara në vende tjera në rajon para 10 viteve.

Duke marrë parasysh këtë, ZRRE-ja propozon që të bëhet një modifikim i vogël në propozimin fillestar për humbjet në shpërndarje:


- Periudha e 'qëndrimit në vend' gjatë të cilës nuk është bërë asnjë reduktim i mëtejshëm në humbjet e lejuara nga vlera përfundimtare e caktuar të PRR1 prej 16.9% të shtyhet për një vit deri në fund të tri viteve në PRR2 (d.m.th., deri në vitin 2020). Duke supozuar që KEDS mund të mbajë normën e njëjtë të trendit të reduktimit të humbjeve si në PRR1 (prej 1.7-1.9 pikë përqindjeje vjetore) atëherë kjo do të thotë se humbjet e realizuara dhe të synuara takohen përafërsisht deri në fund të kësaj date.
- Në mes të viteve 2020 dhe 2022, niveli i lejuar i humbjeve zvogëlohet në vlerën përfundimtare të caktuar të ZRRE-së për PRR2 prej 13.2%. Kjo nënkupton dy vjet të reduktimeve vjetore në humbje prej 1.9 pikë përqindjeje, përafërsisht në përputhje me normën e trendit në PRR1.

Sipas pikëpamjes së ZRRE-së, kjo përfaqëson një balancim të përshtatshëm midis vendosjes së caqeve sfiduese por të arritshme për reduktimin e humbjeve nga KEDS dhe mos shpërblimin e KEDS-it për dështimin në të kaluarën për të arritur reduktimet e pritshme të humbjeve.

Trajektorja e për propozimin e lejimit të humbjeve ose caktuar të humbjeve nga ZRRE, humbjet e realizuara dhe propozimit të KEDS-it për PRR2 janë të paraqitura më poshtë.



Figura 1: Shpërndarja e lejimit të humbjeve



3 Humbjet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit

3.1 Përmbledhja e komenteve të KOSTT-it

Në komentet e veta, KOSTT-i ka ngritur tri çështje kryesore:

- Humbjet e KOSTT-it në përgjithësi kanë shënuar rënie nga viti 2007 deri në vitin 2012, mirëpo pastaj janë rritur për shkak të zhvendosjes së kufirit teknik dhe komercial në mes të OST-së dhe OSSH-së. Që nga prilli 2012, KOSTT-i tani është përgjegjës për humbjet e shkaktuara në transformatorët 220/35/10 kV dhe 110/35/10 kV. Kjo ka çuar në një rritje në humbjet në transmetim prej 18 - 20 GWh në vit.
- Puna aktuale e KOSTT-it në investime në nënstacione të reja (Prishtina 6, Fushe Kosova, Mitrovica, Drenas, Dragash, transformatorët shtesë në NS Gjilani 5, NS Klina dhe NS Lipjan) do të ndikojnë në reduktimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, mirëpo numri më i madh i transformatorëve do të rris humbjet në rrjetin e transmetimit.
- Projektet e reja do të ndikojnë në konfigurimin e rrjetit e gjatë zbatimit të tyre (midis viteve 2018 dhe 2020) që si pasojë do të rrisë humbjet në rrjetin e transmetimit.



Për PRR2, KOSTT-i propozon që këta faktorë të merren parasysh duke kërkuar që një normë mesatare e humbjeve të lejuara prej 1.84% të zbatohet gjatë Periudhës së Dytë Rregullative PRR2.

Në këtë seksion, ZRRE-ja ka shqyrtuar propozimet e KOSTT-it. Konkluzionet e ZRRE-së janë dhënë në fund të seksionit.

3.2 Pozicioni i ZRRE-së për komentet e KOSTT-it

ZRRE-ja është mbështetur në këshillën e konsulentëve të saj teknik për të dhënë një mendim mbi natyrën teknike të komenteve të KOSTT-it dhe kërkesës së tyre për të rritur humbjet e lejuara. Të gjeturat e kësaj analize kanë gjetur argumentet e KOSTT-it si të bazuara mirë për arsyet e mëposhtme:

- Tranzitet e energjisë elektrike shkaktohen nga aktivitetet e palës së tretë, por në të njëjtën kohë kanë ndikim të konsiderueshëm në humbjet e brendshme të rrjetit të transmetimit. Prandaj, tranzitet duhet të merren parasysh në definimin e humbjeve në rrjet dhe duhet të sqarohen. Deri në definimin e statusit të KOSTT-it si zonë rregulluese, ato nuk do të mirren parasysh në kalkulim.
- Pavarësisht nga fakti se energjia që hyn në sistemin e transmetimit nuk ka ndryshuar shumë gjatë viteve 2013-2016, ka pasur një rritje në humbjet në transmetim gjatë vitit 2016. Arsyeja e dhënë nga KOSTT-i është e bazuar në kushtet e pafavorshme të operimit gjatë zbatimit të projekteve të investimeve në rrjet të cilat kanë kërkuar hapjen e unazave në 110 kV. Rezultatet e simulimeve të sistemit energjetik të kryera duke përdorur të njëjtat modele SECI PSS/E sugjeruan se gjatë regjimit të ngarkesës maksimale të sistemit, hapja e unazave në 110 kV në të vërtetë rezultoi me rritje të humbjeve të shkaktuara në transmetim për disa MW krahasuar me regjimin e operimit me unazë të mbyllur. Bazuar në mendimin e konsulentëve teknik, komentet e KOSTT-it për faktorët tjerë ndikues në rritjen e humbjeve të shkaktuara në rrjetin e transmetimit (qarku i hapur i OHL 400 kV Kosova B – Tirana 2, humbjet e transformatorëve d.m.th nivel i pamjaftueshëm i saktësisë së matjes së matësve të mëhershëm të KEDS-it) janë parë si mirë të arsyetuara.

3.3 Konkluzionet dhe propozimet e ZRRE-së për humbjet e OST-së

ZRRE-ja vëren se KOSTT-i ka arritur që të mbajë përafërsisht humbjet e OST brenda nivelit të humbjeve të lejuara prej 1.8% përgjatë Periudhës së Parë Rregullative (PRR1) 2013-2017. Kjo arritje e KOSTT-it është e krahasueshme me rezultatet e OST-ve tjera të BE-së, si dhe më e ulët se disa OST tjera rajonale. Humbjet mesatare të rrjetit të transmetimit në ENTSO-E në vitin 2016 ishin 1.65%.

Bazuar në analizën teknike të paraqitur më lartë, ZRRE-ja propozon që të lejohet KOSTT-i që të mbulojë humbjet mesatare të rrjetit prej 1.78% (mesatarja e realizuar në PRR1) përgjatë Periudhës Rregullative PRR2. Trajektorja për propozimin e lejimit të humbjeve nga ZRRE dhe propozimit të KOSTT për Periudhën e Dytë Rregullative PRR2 është e dhënë më poshtë.



Figura 2 Lejimi i humbjeve për Operatorin e Sistemit të Transmisionit për PRR2

